



Komuna Gjakovë
Municipality of Gjakova
Opština Djakovica

RAPORT PUNE 2020

**Drejtoria e Shëndetësisë dhe e
Mirëqenies Sociale
Komuna e Gjakovës**

SHËRBIMET E DREJTORISË SE SHËNDETËSISË DHE MIREQENIES SOCIALE

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale duke u thirrur ne obligimet ligjore (Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale 03L-040/,Statutin e Komunës se Gjakovës 01/ Nr.011-332/2010 dt 26.12.2008) Ligjin per Shëndetesi 04/L-125.Neni 18/dhe udhëzimet administrative përkatëse/U.A. Shëndetësi Nr. 02/2015; 13/2002 si dhe rregullat tjera ligjore nga (M.SH.P dhe MEF, etj)në kuadër te angazhimeve te saja ofron këto shërbime:

- Planifikimi dhe orjentimi I strategjisë se Kujdesit Parësor Shëndetësor,
- Vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi parësore,
- Vendosjen e objektivave lokale për KPSH,
- Zhvillimin e buxhetit, bazuar në nevojat lokale, duke iu përmbajtur udhëzimeve te MSH dhe MEF;
- Propozimin e buxhetit dhe zbatimin (jetësimin) e buxhetit,
- Vendosjen dhe mbledhjen e bashkë pagesave brenda kornizës së caktuar nga MSH,
- Sigurimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore,
- Mbikëqyrjen e situatës epidemiologjike në nivel komunal
- Zbatimin e normave dhe standardeve të infrastrukturës,
- Mbledhjen dhe analizimin e informatave në nivel lokal,
- Shërbehet me informata për të përcaktuar prioritetet lokale dhe objektivat, në përputhje me strategjinë e kujdesit primar shëndetësor,
- Shërbehet me të dhënat e nivelit qendror për të analizuar cilësinë e shërbimeve dhe përdorimin efektiv të burimeve,
- Përkujdeset për masat e mbrojtjes shëndetësore që kanë të bëjnë me:
 - aktivitetet e dezinfektimit, dezinfektimit, dhe deratizimit,
- Bashkërenditjen dhe mbikëqyrjen e punëve me QKMF, QMF dhe me Ambulanca ne kuader te KPSH-se,
- Mbarëvajtja e punës në Departamentin e Mjekesise Familjare:
 - Sektori I Mjekësisë Familjare
 - Njesia e vaksinimit dhe Imunizimit
 - Sektori I Shendetit Oral
 - Kabineti Radiologjik
 - Sektori I Kujdesit Urgjent
- Zbatimin e Rregulloreve që lëshohen nga Departamenti i Shëndetësisë, MSH dhe
- Ndërmarrjen e fushatave sensibilizuese me organizata qeveritare dhe joqeveritare dhe hartimin e marrëveshjeve me to,
- Raportimin mbi ofrimin e shërbimeve dhe të arriturat komunale në lëmin e shëndetësisë;
- Komuna ka të drejtë për të pasur, zhvilluar dhe për të përdorur pronën, me qëllim të sigurimit të strehimit social të personave brenda komunës,
- Monitorimin e buxhetit dhe aktiviteteve te Qendrës se Punës Sociale
- Planifikimi dhe shpërndarja e subvencioneve shëndetësore Komunale
- Evidentimin e te dhënave lidhur me të gjitha kategoritë e dalura nga luftërat (invalidët civil dhe të luftës për të zhdukur dhe të burgosur etj .
- Dhënia e aplikacioneve për trajtim (mjekim) jashtë vendit per Ministrinë e Shëndetësisë etj

Qëllimi i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Ofrimi i shërbimeve në Drejtorinë e DSHMS-së , KPSH-së dhe QPS-së në cilësi dhe sasi për popullatën e Komunës së Gjakovës.

Plotësimi i kërkesave dhe nevojave të banorëve të Komunës për ruajtjen dhe avancimin e shëndetit dhe mirëqenies sociale.

DSHMS aktivitetin e vetë e kryen përmes:

- Sektorit të Kujdesit Parësor Shëndetësor
- Sektorit të Mirëqenies Sociale
- Sektorit financiar të Dshms-së
- Qendrës për punë Sociale
- Kujdesit Parësor Shëndetësor:
 - -Sektori i Mjekësisë Familjare
 - -Njësia e SISH
 - -Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit
 - -Sektori i Shëndetit Oral dhe Preventiv
 - -Sektori i Kujdesit urgjent
 - -Sektori i Diagnostikës
 - -Kabineti Radiologjik
 - -Laboratori

Personeli i paraparë në DSHMS-së është në këtë përbërje:

- 6 individ në zyrë të Dshms-së
- 349 individ në KPSH
- 18 individ në QPS

Gjate periudhës Janar-Dhjetor 2020 ne zyrën e Dshms-se janë pranuar dhe shqyrtuar 601 lëndë, me kërkesa të ndryshme nga banorët e Komunës së Gjakovës.

Kërkesa për subvencione-ndihmë mjekësore- 400 kërkesa:

Kërkesa për ndihme mjekësore	Aprovuara	Refuzuara
Kërkesat nga Thirrja e pare publike e Subvencioneve		
Përfitues	146	
Jo përfitues		179
Kërkesat nga Thirrja e dyte Publike Subvencioneve	40	34
Kërkesa për trajtime mjekësore jashtë vendit	1	
Kërkesa tjera te ndryshme	130	
Kërkesa për pagese te qeras	17	
Pagesa te qeras	5	
Kërkesa për ndërtim te shtëpijave		4
Kërkesa për strehim		48

AKTIVITETET E ZYRES PER RI-INTEGRIM NE KUADER TE DSHM-se

Komisioni Komunal për Ri-integrim(i cili kryesohet nga DSHMS) gjatë vitit 2020 i shqyrtoi këto kërkesa.

	Aprovuara	Refuzuara
Kërkesa	30	
Banim me qera	12	
Vazhdimi i qerave	16	
Pako dimërore(me rregulloren e re e aprovon MPB	2	

Donacione dhe Aktivitete te përgjithshme te Drejtorisë përgjatë vitit 2020

Me fillimin e shfaqjes së pandemisë në vendin tonë donator të ndryshëm iu janë ofruar komunës për bashkëpunim.

Prej datës 14.03.2020 deri me 30.07.2020 është bërë shpërndarja plotë 12 here në ambientet e Palestrës Sportive “Shani Nushi” Gjakovë duke respektuar rregullat mbrojtëse ndaj Covid-19 dhe gjithashtu shpërndarja është bërë nga zyrtaret komunal dhe me asistencën e policisë.

Shpërndarja e këtyre pakove është bërë në këto data dhe nga këta donator:

- 14.03.2020- Shoqata “ Bereqeti” 52 pako ushqimore dhe higjienike
- 27.03.2020- Elkos Group & UNICEF 320 për 320 familje pako ushqimore, miell, qumësht dhe pako higjienike
- 10.04.2020- Jetimat e Ballkanit për 100 familje pako ushqimore dhe miell
- 23.04.2020- Shoqata “Bereqeti” për 300 familje pako ushqimore dhe pako higjienike
- 28.04.2020-Fondacioni për shoqëri të hapur për 500 familje pako ushqimore dhe higjienike për komunitetin RAE
- 02.05.2020-Iniciativa “Besa për Kosove” për 97 familje pako ushqimore dhe higjienike
- 11.05.2020- Unicef dhe Usaid për 150 familje pako higjienike
- 15.05.2020-Unmik për 75 familje pako ushqimore dhe 40 higjienike
- 19.05.2020-AQH për 572 familje pako ushqimore dhe higjienike për komunitetin RAE
- 22.05.2020- Shoqata “ Bereqeti” për 153 familje pako ushqimore dhe higjienike
- 26.05.2020-Shoqata “ Jetimat e Ballkanit” për 100 familje pako ushqimore, pako higjienike dhe miell
- 30.07.2020-Shoqata “Bereqeti” për 200 familje pako ushqimore dhe higjienike

Këto pako ushqimore dhe higjienike janë shpërndare tek personat me kushte të vështira ekonomike (nga listat e Qendrës për Punë Sociale), personat me aftësi të kufizuara (nga listat e HENDIKOS), nënat vetushqyese, familjet strehuese, Shoqata e Shurdh-memeceve, Shoqata e të verbërve, Shëndeti mendor, Shpija e Sigurt, Medika-Gjakova, Medika-Kosova etj.

Marrëveshje bashkëpunimi

Gjate vitit 2020 DSHMS ka nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi:

-Medika Gjakova

Aktivitetet e përgjithshme realizuar nga KPSH dhe përkrahur nga DSHMS

-Gjate vitit 2020 përkrahur nga Kryetari i Komunës, është formuar Grupi Punues Profesional për te realizuar Planin I Zhvillimit Institucional Te kujdesit Parësor Shëndetësor –Master Planin për vitin 2021-2025. Ky plan është aprovuar me Vendim të asamblesë dhe është në fuqi nga muaji Nëntor 2020.

-Trajnime të ndryshme organizuar nga AQH-Accessible Quality Healthcare partner me Ministrinë e Shëndetësisë -Edukim Shëndetësor në Komunitet.

-Kryerja e vizitave sistematike për shëndetin e përgjithshëm të fëmijëve si dhe higjienën orale, në të gjitha shkollat e Komunës së Gjakovës -përkrahur nga DSHMS në bashkëpunim me DKA.

-Imunizimi i fëmijëve sipas kalendarit të vaksinimit, neper shkolla dhe fshatra të Komunës së Gjakovës nga ekupe të vaksinimit përkrahur nga DSHMS.

-Aktivitete tjera edukuese nga stafi i QKMF në bashkëpunim me Institutin e Shëndetësit Publik realizuar në shkolla të Komunës së Gjakovës, në muajin shkurt -Ligjërata në shkolla për mbrojtje nga Covid-19.

Fushatat tjera vetdijesuse janë ndërprerë për shkak të Pademise Covid -19

Llojet tjera te shërbimeve, dhe vërtetimeve e lëshuara ne DSHMS gjate kësaj periudhe 2020.

- Lëshimi i vërtetimeve për Viktima Civile të Luftës (Pension dhe benificione të ndryshme), Gjithsej gjate kësaj kohe janë lëshuar (65) Gjashtëdhjetë e pesë Vërtetime
- Lëshimi i vërtetimeve për Invalid Civil të Luftës (Pension dhe benificione të ndryshme), Gjithsej gjate kësaj kohe janë lëshuar (55) Pesë e një Vërtetime.
- Lëshimi i vërtetimeve për Dëshmore të rëne në Luftën e Fundit (Pension dhe benificione të ndryshme) Gjithsej gjate kësaj kohe janë lëshuar (31) Tridhjetë e një Vërtetime.
- Përgatitja e dokumentacioneve të nevojshme, si dhe pranimi i dokumenteve të tyre
- Hapja e librave për 2020
- Lëshimi i (22) Njëzet e dy vërtetimeve për te Burgosurit e Luftës së fundit.
- Lëshimi i Librezave për njerëzit të prekur nga Lufta e fundit, më te cilën lirohen nga Shërbimet shëndetësore.
- Gjithashtu gjate kësaj kohe më është kërkuar që të dale në teren dhe te verifikoje Banesat Sociale.
- Verifikimi i Banesave Sociale te Komunës si dhe raporti qe i është dërguar Drejtoreshës
- Pjesë e Komisionit për verifikimin e Banesave Sociale për vitin 2019, ku është bërë verifikimi i gjendjes faktike ne teren
- Takim avokues online rreth mbështetjes financiare për strehimore e viktimave të dhunës ne familje e organizuar nga OSCE—20.12.2020
- Tryeze e rrumbullakët e thirrur nga Zyra për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me OSBE. Dhjetor:10.12.2020- Online
- Pjesëmarrës në Komisionin për vlerësimin e dokumentacionit të Banimi Social në Gjakovë.

PROJEKTET E PUNUARA SIPAS PLANIFIKIMIT PER VITIN 2020

Përshkrimi përmbledhës i kontratave të planifikuara për këtë vit fiskal.

Renovimet, riparimet dhe mirëmbajtja e objekteve të KPSH:

- QENDRA KRYESORE E MJEKESISE FAMILJARE
- Qmf- DOBLIBARE
- Qmf-CERMJAN
- Qmf- ROGOVE
- Qmf –DARDANIA
- Amf- KRELAN
- Amf-DOBLIBARE
- Amf-GUSKE
- Amf-DOL
- AMf NOVOSELLE
- Amf BISHTAZHIN
- QENDRA PER PUNE SOCIALE

Projektet të cilat janë realizuar në vazhdimësi për funksionimin e K.P.Sh. dhe Q.P.S

- Raportimi dhe vlerësimi i projekteve në proces, ato në përfundim, dhe të tjerat në vazhdimësi ne kuadër të përfundimit të vitit 2020 pranë DSHMS-së.
- Në bashkëpunim me Drejtorin e DSHMS-së është bërë organizimi i punës tek te varurit pranë kësaj drejtorie, duke ofruar udhëzime dhe monitorim i punës së Kujdesit Parësor Shëndetësor -së si dhe Qendrës për Pune Sociale.
- Gjate muajve Shkurt- Mars vizita ne teren. Më qellim të përmirësimit të përmirësimit të shërbimeve dhe cilësisë së punës, është bërë monitorimi dhe vlerësimi i gjendjes së përgjithshme të infrastrukturës dhe shërbimeve ne 10 pikat e QMF-së, dhe 15 pikat e AMF-së të Komunës së Gjakovës, si dhe QPS-se.
- Hartimi i specifikacioneve për hapje të kontratave të planifikuara për këtë vit fiskal, si dhe vlerësimi i tyre pranë zyrës së prokurimit për nevoja të Kujdesit Parësor Shëndetësor, si me poshtë:
 - Renovimi i objekteve të Qkmf-se, QMF-ve si dhe AMf-ve neper fshatra.
 - Furnizim me barna emergjente
 - Furnizim me material hargjues dhe pajisje stomatologjike
 - Furnizim me aparatura mjekësorë dhe jo mjekësore
 - Pajisje dhe furnizim me aparature pune për laborator stomatologjik.
 - Automjet për vizita për njësinë e vaksinimit
 - Furnizimi me 2 pajisje të Eho-kardiografit- statik
 - Furnizim me pajisje mjekësore- oksigjenator për nevoja të QKMF-se.
 - Pajisje dhe furnizim me kompjuter për KPSH dhe Qendrën për Pune Sociale .
 - Ndërtimi i ashensorit për QKMF ekzistuese.
 - Shërbimi për mirëmbajtje dhe pastrim të objekteve të KPSH dhe Qps se.
 - Mirëmbajtja e aparaturave stomatologjike, mjekësore dhe të laboratorit.
 - Tenderi i furnizimeve mjekësore të materialit për laborator hematologjik- biokimik.
 - Ndërtimi i ashensorit dhe kafazit të ashensorit
 - Blerja e testeve serologjike. Ne fazën e parë janë siguruar 4.500 teste IGG Dhe 4.500 teste IGM.
 - Ne fazën e dytë janë siguruar 1.800 teste IGG dhe 1.800 IGM.
- Me kërkesën e Dshms-se drejtuar KRU-Gjakova këtë vit është paraparë kyçja e tyre në rrjetin e kanalizimit dhe të ujësjellësit për 8 Ambulanca të Mjekësisë Familjare neper fshatra. Gjate kësaj kohe të raportimit është kryer kyçja e 6 ambulancave në rrjetin e KRU Gjakova .
- Të hyrat e planifikuara për vitin 2020 kanë qene 70.000 euro. Nga kategoria e mallrave e dhe shërbimeve 60.000 si dhe 10.000 euro nga kategoria e pagave. Deri në këtë periudhë gjithsejtë të hyra janë 66.220 Euro.

- Po ashtu gjate periudhës 12 mujore janë kryer dy Thirrje Publike.
- Thirrja e pare publike për subvencione apo ndihme shtese ne lëmin e shëndetësisë. Është bere përpilimi i formularëve, shqyrtimi i te gjitha kërkesave te qytetareve, të cilët kane aplikuar për ndihma ne lëmin e shëndetësisë dhe është hartuar regjistri i ri me emrat e përfituesve te subvencioneve te DSHM-se.
- Ne muajin shtator nga data 07.09.2020-18.09.2020 është bere Thirrja e dyte Publike apo ndihma ne lëmin e shëndetësisë sipas Rregullores se re e cila është miratuar këtë vit.
- DSHMS qe nga periudha e 16 marsit ku është shpallur Pandemia Covid-19.e kryen edhe shërbimin e Shtabit Emergjent. Deri me tani kemi pasur 280 shërbime te ndryshme për qarkullim te lëvizjes te cilat iu janë ofruar qytetareve.
- Çdo dite ofrimi i informatave dhe shërbimeve për te gjitha palët ndaj kërkesave te tyre.

TOTALI BUXHETI 2020

PERSHKRIMI	DSHMS	KPSH	QPS	TOTALI
PAGA	33,381.36	3,157,617.70	104,163.27	3,295,162.33
ME SH	20,147.64	583,348.00	40,000.00	643,495.64
KOMUNALE	0	60,000.00	12,000.00	72,000.00
KAPITALE	0	206,665.45	0	206,665.45
SUBVENCIONE	50,000.00		5,000.00	55,000.00
TOTALI	103,529.00	4,007,631.15	161,163.27	4,272,323.42